



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 31, datë 14.07.2020

SHQYRTIM RAPORTI AUDITIMI

Autoriteti kontraktor	INSTITUCIONI I PREFEKTIT TË QARKUT TIRANË
Organi auditues	Kontrolli i Lartë i Shtetit
Numri i procedurave të audituara	3 (tre)
Lloji i procedurës/ave të audituara	Procedurë "E hapur" : 1 (një) Procedurë "Kërkesë për propozim" : 2 (dy)
Konstatimet kryesore	1. Autoriteti Kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, lidhur me dokumentacionin e hartuar për përlogaritjen e fondit limit, në një procedurë prokurimi të audituar. 2. Autoriteti Kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, lidhur me hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk vijnë në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, në një procedurë prokurimi të audituar. 3. Autoriteti Kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, lidhur me kualifikimin e operatorëve pjesëmarrës, në një procedurë prokurimi të audituar.
Masat e marra	Në bazë të nenit 13, pika 2/i, dhe nenit 72, 1/gj/i dhe 2, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, APP vendosi të dënojë me gjobë 6 (gjashtë) persona të evidentuar përgjegjës, për mospërmbyllje të detyrimeve të përcaktuara në nenet 46 dhe 53 të këtij ligji, si dhe t'i propozojë titullarit të Autoritetit Kontraktor, marrjen e masës disiplinore ndaj 1 (një) personi, të evidentuar përgjegjës, për mospërmbyllje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 28 të këtij ligji.